

Preportr

PAGESA SHITESË PËR ANGAZHIME BAZË



Profesorët e Universitetit të Prishtinës janë paguar shtesë për vlerësimin e studentëve dhe mentorimin e temave të diplomës për vite me radhë. Nga këto aktivitete, që në fakt do të duhej të ishin pjesë e punës së tyre bazë, ata kanë fituar shuma të mëdha parash. Auditori ka gjetur shkelje të shumta në këto pagesa.

Leonida Molliqaj, Qëndrim Bunjaku

Pagat dhe mëditjet e profesorëve përbëjnë rreth 74% të buxhetit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Profesorët në UP kanë paga mujore ndër më të lartat në rajon, ato sillen prej 700 deri në 1,430 euro. Megjithatë, shumica e personelit vite me radhë kanë fituar shumë më shumë pasi që në bazë të një rregulloreje financiare që ka qenë në fuqi deri në shtator të vitit 2017, ata janë paguar shtesë për mentorimin e temave të diplomës, mbajtjen e provimeve, orët mbi normë, orët si bashkëpunëtorë të jashtëm si dhe pjesëmarrjen në komisionet e përhershme të senatit. E hartuar në kohën kur paga e një profesori ishte më e ulët, qëllimi i kësaj rregulloreje ishte të krijonte të ardhura më të mira për profesorët, mirëpo e njëjta edhe pas rritjes së pagave nga Qeveria e Kosovës nuk është shfuqizuar në tërësi.

Për të analizuar këto të hyra Preportr ka kërkuar nga Rektorati i Universitetit të Prishtinës listat e pagesave të rregullta dhe atyre shtesë të profesorëve për fakultetet Ekonomik, Juridik dhe Filozofik për vitet 2014-2015 dhe 2015-2016. Kërkesa për qasje në këto të dhëna është dorëzuar në qershor të vitit 2017 bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, por për të njëjtën Rektorati fillimisht nuk ka kthyer përgjigje duke u thirrur në mbrojtjen e të dhënave personale të profesorëve. Lidhur me këtë Preportr ka bërë ankesë dhe ka kërkuar interpretim nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e cila në përgjigjen e saj ka theksuar se meqë Universiteti i Prishtinës është një institucion publik dhe paraqet interes për publikun, atëherë duhet të gjendet një ekuilibër në mes të mbrojtjes së të dhënave personale dhe interesit publik.

“E drejta e mbrojtjes së të dhënave personale është e drejtë fundamentale, por nuk është e drejtë absolute, është e drejtë e cila duhet të balancohet me të drejtat e tjera, veçanërisht me të drejtën për lirinë e informacionit. Është e mjaftueshme që kërkuessit t’i jepen të dhënat e numrit të profesorëve, emrat, gradat, dhe shumica e mjeteve që ata kanë marrë nga Buxheti Publik, duke u anonimizuar të dhënat personale, të cilat konsiderohen të dhëna

Pagesat shtesë sipas rregullores së vjetër



Pjesëmarrja në
komisione të ndryshme

50.00€

Kryetari i Komisionit

30.00€

Anëtari i Komisionit

25.00€

Profesor i asociuar

Niveli Bachelor

20.00€

Mentori

10.00€

Anëtari i komisionit

Niveli Master

250.00€

Mentori

90.00€

Kryetari i komisionit

80.00€

Anëtari i komisionit

3.00€

Niveli Master

Mbikëqyrja e punimeve
të diplomës bachelor
dhe master



të ndjeshme e që duhet të plotësohen disa kritere specifike me rastin e përpunimit të këtyre të dhënave. Kërkesi i këtyre informacioneve, të dhënat e marra nga UP duhet ti përdorë vetëm për qëllimet për të cilën janë marrë dhe nuk mund t'i përdorë për qëllime tjera”, thuhet në përgjigjen e Agjencisë.

Edhe pas këtij interpretimi, Rektorati ende nuk është përgjigjur pozitivisht në kërkesën tonë, dhe si rrjedhojë ka shkelur ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe ka treguar edhe njëherë mungesën e transparencës së këtij institucioni publik.

Mijëra euro përfitime shtesë nga provimet dhe mentorimet

Marrë parasysh numrin e madh të studentëve që ka universiteti publik, të hyrat nga aktivitetet shtesë siç janë mbajtja e provimeve dhe mentorimi i temave të diplomës ua rrisnin profesorëve pagën shpesh për shumata të mëdha.

Pavarësisht që vlerësimi i studentëve do të duhej të ishte pjesë e detyrës bazë së secilit profesor, rregullorja financiare ua ka mundësuar atyre që të gjenerojnë të hyra shtesë për çdo studentë që ka paraqitur provimet në lëndën e tyre.

Gjithashtu pagesa për mentorimin e temave të diplomës ka paraqitur një problem tjetër ndër vite në UP. Meqenëse nuk ishte i përcaktuar ndonjë limit se sa mentorime mund të bëhen gjatë një viti nga një profesor, u ka mundësuar disa prej tyre që të përfitojnë shumata të konsiderueshme të të hyrave.

Kjo mënyrë e mentorimit mund të ketë ndikuar drejtpërdrejt edhe në cilësinë e temave të diplomës. Në një hulumtim të Preportr mbi shitblerjen e temave të diplomës është vërtetuar se numri i madh i mentorimeve brenda një viti nga i njëjti profesor hapë mundësi për keqpërdorime ku shumë shpesh disa studentë diplomojnë tek i njëjti profesor me temën e njëjtë.

Në mungesë së qasjes në të dhënat zyrtare nga Universiteti i Prishtinës për numrin e studentëve që kanë paraqitur provimet, Preportr ka shikuar të gjitha rezultatet e provimeve të publikuara në web-siten e Fakultetit Ekonomik për vitin kalendarik 2016.

Shumë nga profesorët kanë publikuar online vetëm emrat e studentëve të cilët kanë kaluar provimin, rrjedhimisht ka qenë e pamundur të dihet numri i saktë i studentëve që kanë paraqitur provimet.

Nga të dhënat e nxjerra ka rezultuar që për vitin 2016 minimumi i studentëve që kanë paraqitur provim është rreth 46 mijë në 50 profesorë të ndryshëm.

Sipas këtyre të dhënave profesorët në Fakultetin Ekonomik për vitin 2016 kanë marrë minimum afër 28 mijë euro shtesë për studentët që kanë paraqitur provimet në lëndët e tyre.

Vetëm gjatë këtij viti ka profesorë që kanë mbajtur provim

për afër 4 mijë studentë dhe kanë marrë pagë shtesë mbi 2 mijë e 600 euro.

Nga 50 profesorët, nëntë prej tyre janë pagur shtesë mbi 1 mijë euro për provimet e mbajtura brenda vitit 2016.


Rektorati i Universitetit të Prishtinës nuk ka ofruar të dhëna as për numrin e mentorimeve të diplomave për profesorët. Preportr ka gjetur në web-siten e Fakultetit Ekonomik tri lista me studentët të cilët kanë diplomuar gjatë viteve 2014, 2015 dhe deri në maj të vitit 2016.

Gjatë këtyre dy vite e gjysmë në Fakultetin Ekonomik në nivelin Bachelor kanë diplomuar dy mijë e 429 studentë. Në një llogaritje që ka bërë Preportr duke krahasuar numrin e temave me pagesën 20 euro për mentorimin e një teme në bachelor është gjetur se profesorët që kanë mentoruar kanë marrë pagë shtesë mbi 48 mijë euro për dy vite e gjysmë.

Vetëm në vitin 2014 profesori Safet Merovci ka mentoruar 466 tema të diplomës, ku për këto është paguar shtesë nëntë mijë e 320 euro.

**48 mijë euro
pagesa shtesë
për mentorim
të temave të
diplomës**

Arben Hajrullahu, profesor në Fakultetin Filozofik ka thënë se është e rëndësishme të shtohet numri i profesorëve në mënyrë që të largohet praktika e çdo mbinorme apo pagese shtesë. Sipas tij të ardhurat vjetore të secilit person që paguhet nga buxheti shtetëror duhet të jenë publike duke përfshirë këtu edhe profesorët.



Tetë profesorë të Fakultetit Ekonomik për dy vite e gjysmë kanë mentoruar mbi 100 tema të diplomës

	2014	2015	2016	Total
Safet Merovci	466	154	25	645
Myrvete Badivuku	45	82	36	163
Nail Reshidi	46	77	17	140
Fatos Ukaj	67	53	13	133
Nagip Skenderi	17	67	38	122
Justina Pula	51	42	19	112
Nexhmie Berisha	62	36	11	109
Skender Ahmeti	50	46	7	103

“Puna shtesë duhet kompensuar në një formë a tjetër dhe në rrethana normale kjo nuk do të duhej të ishte problematike. Brenga është te mungesa e cilësisë, keqpërdorimet nga qarqe të mbyllura dhe te jo transparencë. Në parim mëditjet dhe pagesat shtesë rrisin mundësinë e abuzimit. Andaj, ato duhet të jenë të rregulluara mirë, qartë dhe para së gjithash transparente”, ka thënë Hajrullahu.

Rregullorja e re shpëtoi një milion euro

Megjithatë nga viti i kaluar me hyrjen në fuqi të rregullores së re për të ardhurat personale në UP, është larguar pagesa

shtesë për mbajtjen e provimeve.

Kjo ishte kërkesë edhe e Komitetit Këshillëdhënës për Financa të Universitetit të Prishtinës i cili është themeluar me ndihmën e Programit TLP-SP që bashkë financohet nga MASHT dhe USAID.

Sipas Komitetit, eliminimi i pagesës shtesë për provime që është ndaluar vitin e fundit i ka shpëtuar buxhetit të UP-së rreth 1 milion euro dhe se kjo do të jetë mundësi e mirë që këto të hyra të riprogramohen dhe të shpenzohen në mënyrë më efektive.

“Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të arsimit të lartë në avancimin e Kosovës, ne besojmë se profesorët duhet të paguhet mirë dhe të stimulohen për të kryer mësimdhënie, kërkime dhe shërbime në nivelin më të lartë. Është e pazakontë që profesorët të marrin pagesë shtesë për punë të tjera që janë

Numri i temave të mentoruara dhe pagesat për periudhën 2014-qershor 2016 në Fakultetin Ekonomik

Numri i temave të diplomave të mentoruara

Emri i profesorit	2014	2015	2016	Total
Safet Merovci	466	154	25	645
Myrvete Badivuku	45	82	36	163
Nail Reshidi	46	77	17	140
Fatos Ukaj	67	53	13	133
Nagip Skenderi	17	67	38	122
Justina Pula	51	42	19	112
Nexhmie Berisha	62	36	11	109
Skender Ahmeti	50	46	7	103
Besnik Krasniqi	49	48	2	99
Rrustem Asllanaj	32	44	19	95
Meleke Behluli	32	42	10	84
Vehbi Ramaj	23	25	18	66
Sinan Ademaj	19	31	9	59
Ymer Havolli	24	20	14	58
Driton Balaj	28	26	2	56
Gazmend Luboteni	14	22	6	42
Aferdita Berisha	22	8	3	33
Arben Dermaku	16	10	7	33
Drita Konxheli	12	10	9	31
Hysen Ismajli	9	11	3	23
Enver Kutllovci	10	8		18
Florentina Xhelili	5	9	4	18
Muhamet Aliu	5	10	1	16
Avdullah Hoti	9	5	1	15
Ejup Fejza		11	3	14
Hykmete Bajrami	14			14
Mihane Berisha	9	3	1	13
Driton Qehaja	8	2	1	11
Valentin Toçi	5	5	1	11
Berim Ramosaj	3	5	1	9
Mujë Gjonbalaj	4	4	1	9
Gazmend Qorraj	4	3	1	8
Visar Rrustemi	3	3	2	8
Ismet Begu	2	3	2	7
Petrit Gashi	5	1	1	7
Ajet Ahmeti	3	3		6
But Dedaj	3	3		6
Adriatik Hoxha	3	2		5
Besim Beqaj	2	2	1	5
Sejdi Rexhepi		3	2	5
Shpresa Reshidi		2	3	5
Armand Krasniqi	2	2		4
Lutfi Zharku	1	1		2
Mrika Kotorri	1		1	2
Rahmije Mustafa		1	1	2
Ramiz Livoreka	2			2
Partizan Shuperka	1			1

Pagesat për mentorime të temave të diplomës

Emri i profesorit	2014	2015	2016	Total
Safet Merovci	9,320.00	3,080.00	500.00	12,900.00
Myrvete Badivuku	900.00	1,640.00	720.00	3,260.00
Nail Reshidi	920.00	1,540.00	340.00	2,800.00
Fatos Ukaj	1,340.00	1,060.00	260.00	2,660.00
Nagip Skenderi	340.00	1,340.00	760.00	2,440.00
Justina Pula	1,020.00	840.00	380.00	2,240.00
Nexhmie Berisha	1,240.00	720.00	220.00	2,180.00
Skender Ahmeti	1,000.00	920.00	140.00	2,060.00
Besnik Krasniqi	980.00	960.00	40.00	1,980.00
Rrustem Asllanaj	640.00	880.00	380.00	1,900.00
Meleke Behluli	640.00	840.00	200.00	1,680.00
Vehbi Ramaj	460.00	500.00	360.00	1,320.00
Sinan Ademaj	380.00	620.00	180.00	1,180.00
Ymer Havolli	480.00	400.00	280.00	1,160.00
Driton Balaj	560.00	520.00	40.00	1,120.00
Gazmend Luboteni	280.00	440.00	120.00	840.00
Aferdita Berisha	440.00	160.00	60.00	660.00
Arben Dermaku	320.00	200.00	140.00	660.00
Drita Konxheli	240.00	200.00	180.00	620.00
Hysen Ismajli	180.00	220.00	60.00	460.00
Enver Kutllovci	200.00	160.00	-	360.00
Florentina Xhelili	100.00	180.00	80.00	360.00
Muhamet Aliu	100.00	200.00	20.00	320.00
Avdullah Hoti	180.00	100.00	20.00	300.00
Ejup Fejza	-	220.00	60.00	280.00
Hykmete Bajrami	280.00	-	-	280.00
Mihane Berisha	180.00	60.00	20.00	260.00
Driton Qehaja	160.00	40.00	20.00	220.00
Valentin Toçi	100.00	100.00	20.00	220.00
Berim Ramosaj	60.00	100.00	20.00	180.00
Mujë Gjonbalaj	80.00	80.00	20.00	180.00
Gazmend Qorraj	80.00	60.00	20.00	160.00
Visar Rrustemi	60.00	60.00	40.00	160.00
Ismet Begu	40.00	60.00	40.00	140.00
Petrit Gashi	100.00	20.00	20.00	140.00
Ajet Ahmeti	60.00	60.00	-	120.00
But Dedaj	60.00	60.00	-	120.00
Adriatik Hoxha	60.00	40.00	-	100.00
Besim Beqaj	40.00	40.00	20.00	100.00
Sejdi Rexhepi	-	60.00	40.00	100.00
Shpresa Reshidi	-	40.00	60.00	100.00
Armand Krasniqi	40.00	40.00	-	80.00
Lutfi Zharku	20.00	20.00	-	40.00
Mrika Kotorri	20.00	-	20.00	40.00
Rahmije Mustafa	-	20.00	20.00	40.00
Ramiz Livoreka	40.00	-	-	40.00
Partizan Shuperka	20.00	-	-	20.00

pjesë rutinore e punëve të tyre, veçanërisht provimeve, disertacioneve dhe punëve në komisione”, kanë thënë në përgjigjen e tyre ky Komitet.

Sipas rregullores së re poashtu është përcaktuar limiti i mentorimeve të temave të diplomës për një profesor megjithatë pagesat për mentorime vazhdojnë të mbetën të njëjta.

Auditori kishte gjetur parregullsi të shumta në pagesa të profesorëve

Raportet e Auditorit të Përgjithshëm me vite me radhë kishin veçuar shkelje të shumta në pagesat shtesë të profesorëve.

Në vitin 2014 raporti i Auditorit kishte gjetur se zbatimi i rregullores për të ardhurat personale nuk ishte konsistent, ngase në shumë raste ishin bërë pagesa në kundërshtim me dispozitat e saj si dhe kontrollet në këtë fushë të shpenzimeve nuk ishin efektive për të siguruar arsyeshmërinë e duhur të pagesave për vijueshmërinë e ligjëratave dhe pagesave të orëve mbi normë.

Një prej problemeve më të theksuara në raport me pagesat shtesë është mungesa e dokumentimit të vijueshmërisë së procesit mësimor në fakultete dhe mos aplikimi i sanksioneve. Rregullorja për të ardhurat personale e UP-së, përkatësisht Neni 12 parasheh që “Çdo orë e paraqitur për pagesë duhet të arsyetohet me lista të studentëve të pranishëm, të verifikuara nga personi i autorizuar i fakultetit”.

Në tetë nga 97 mostrat e testuara në vitin 2016, Auditori kishte vërejtur se profesorët nuk shënojnë fare orën dhe datën e mbajtjes së ligjëratës, e disa të tjerë shënojnë vetëm fillimin e orës së mbajtjes së ligjëratës. Kjo dukuri rrit rrezikun e kryerjes së pagesave të parregullta për orë që nuk janë mbajtur dhe ka ndikime negative në cilësinë e shërbimeve.

“Përderisa zyrtarët përgjegjës për kalkulimin e orëve të mbajtura e bëjnë kalkulimin pa ato dëshmi përkatëse. Po ashtu, në një (1) rast nuk na janë ofruar fare dëshmitë (vijueshmëria) e mbajtjes së ligjëratave, derisa i punësuari kishte marr pagë të plotë. Kompensimi për orë mësimore jo të kompletuara me dëshmi, mund të ketë ndikim negativ financiar dhe rrit rrezikun që shpenzimet të jenë më të larta se shërbimet e pranuar”, thuhet në raport.

E gjetura për muajin prill të vitit 2014 tregon se në 7 nga 36 rastet e testuara, mësimdhënësit nuk e kanë plotësuar normën e orëve obligative për të cilën janë kompensuar.

Rregullorja për të ardhurat personale parasheh që pagat duhet të reduktohet pjesërisht kur stafi nuk i plotëson të gjithë obligimet, 50€ për orë të humbur për profesorë, dhe 25€ për

asistent. Profesorët janë kompensuar me paga të plota dhe ndalesa nuk janë aplikuar.

Sipas Auditorit kompensimi i profesorëve me nga 60 cent për secilin student që i nënshtrohet provimit, kishte shkaktuar kosto të panevojshme për UP-në për shkak se mbajtja e provimeve do të duhej të jetë pjesë e pandashme e detyrave të punës për të cilën profesorët e marrin pagën bazë dhe eventualisht honoraret.

Si problem tjetër ishte theksuar edhe pagesa për mentorim të temave të diplomës. Përderisa rregullorja e Fakultetit Ekonomik parashihte limit lidhur me numrin e temave që ka të drejtë një profesor të mentoroj brenda vitit, Auditori kishte gjetur se e njëjta është shkelur disa herë, pra profesorët kanë mentoruar dhe rrjedhimisht janë paguar më shumë se sa që kishin pasur të drejtë.

“Mosrespektimi i limitit të lejuar të temave për mentorim nga profesorët është në kundërshtim me standardin e përcaktuar me rregullore. Kjo mund të ndikoj negativisht në cilësinë e mentorimit, mund të jetë diskriminues ndaj stafit tjetër akademik, dhe shkakton shpenzime në kundërshtim me rregulloren e aplikueshme”, thuhet në raport.

E gjetura për muajin prill të vitit 2014 tregon se në

**7 nga 36
rastet e
testuara,**

mësimdhënësit nuk e kanë plotësuar normën e orëve obligative për të cilën janë kompensuar.

Preportr

BULETINI

Preportr – Qendra Kosovare për Gazetari Hulmuese është një projekt i filluar nga Organizata anti-korrupsion në Kosovë – ÇOHU. Projekti ka për qëllim ngritjen dhe mbështetjen e gazetarisë hulmuese në Kosovë përmes ofrimit të një hapësire alternative për gazetarët entuziastë që të transmetojnë hulumtimet e tyre pa frikën e censurës.

BULETINI REDAKTOHET NGA:

Arton Demhasaj

AUTORËT:

Leonida Molliqaj, Qëndrim Bunjaku

DESIGN AND LAYOUT:

envinion

TELEFONI:

038 248 506

E-MAIL:

office@preportr.com.
preportr.cohu.org

Shënim: Organizata Çohu është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të Organizatës Çohu! dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS.



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



KOALICIONI PËR INTEGRITET DHE
TRANSPARENCE NË UNIVERSITET



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society